

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1106 Prot.

Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 109, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 48, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike të konstatuara gjatë punimeve të zbatimit të **projektit "Objekt me funksione tregtare " godina e ish Markatës, Berat**, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Berat,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike të konstatuara gjatë punimeve të zbatimit të **projektit "Objekt me funksione tregtare " godina e ish Markatës, Berat**, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Berat.
2. Të dokumentohet nga ASHA kolektori, në segmentin e zbuluar gjatë zbatimit të projektit "Objekt me funksione tregtare " godina e ish Markatës, Berat.
3. Investitori, me shpenzimet e tij, duhet të kryejë rilevimin e terrenit duke hedhur në të gjurmën e kolektorit me kuotat përkatëse të tij, si dhe riparimin e segmentit të dëmtuar të kolektorit. Genplani me terrenin e rilevuar dhe gjurmën e kolektorit me kuotat përkatëse të tij, të depozitohet pranë ASHA-ës.
4. Projekti "Objekt me funksione tregtare" godina e ish Markatës, Berat, në funksion të gjendjes faktike, duke marrë parasysh riparimin e segmentit të dëmtuar të kolektorit dhe ruajtjen e segmentit tjetër të kolektorit brenda sheshit të ndërtimit, të kalojë për shqyrtim në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO